



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

# Doracak për sinjalizimin në sektorin privat



Implementuar nga:

**FOL**

Mbështetur nga:



TITULLI:

**Doracak për sinjalizimin në sektorin privat**

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

Qershor, 2023

WEBSITE:

[www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

ADRESA:

Andrea Gropa, No.35 10000 Prishtinë, Kosovë

**Të drejtat e autorit @ 2023.** Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij Udhëzuesi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Publikimi i këtij Doracaku është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të Projektit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punës për grupet e cënueshme në tregun e punës". Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes FOL dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Advocacy Training and Resource Center – ATRC ose BIRN Kosova.

# Përmbajtja

Metodologjia	4
Hyrje	5
Çka është sinjalizimi?	6
Kush është sinjalizuesi?	7
Kush është zyrtari përgjegjës për sinjalizimin?	9
Pse duhet të sinjalizoj?	10
Kush përfshihet në sektorin privat?	11
Cilat janë llojet e sinjalizimit?	12
Për çka mund të sinjalizohet?	13
Skenarë të sinjalizimit në sektorin privat	14
Sinjalizimi i brendshëm	14
Sinjalizimi i jashtëm	15
Sinjalizimi publik	15

# Metodologjia

Ky doracak është hartuar për të ofruar udhëzime të përgjithshme për të kuptuar dhe zbatuar "Ligjin nr. 065/L085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesëve" në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat. Synimi i këtij doracaku është të ju ofrojë ndihmë të gjithë të punësuarve në sektorin privat që mund të dëshirojnë të sinjalizojnë veprime ose praktika të dyshimta në vendin e tyre të punës.

Përmes përgjigjeve të dhëna në pyetjet themelore të cilat përfshijnë definicionin e sinjalizimit, se kush quhet sinjalizues dhe person përgjegjës për sinjalizimin, rastet në të cilat mund të bëhet sinjalizimi, llojet e sinjalizimit, si dhe krijimin e skenarëve për secilin lloj të sinjalizimit, FOL synon të krijojë një pasqyrë të përgjithshme dhe të kuptueshme për punonjësit e sektorit privat si sinjalizues potencialë në të ardhmen.

Doracaku përmban edhe skenarë të sinjalizimit, që kalon në tri instanca, pra në sinjalizim brenda insitucionit (sinjalizim të brendshëm), sinjalizim tek autoriteti kompetent (sinjalizimi i jashtëm) dhe sinjalizimi në media (sinjalizim publik).

Ky doracak ka për qëllim që të lehtësojë informimin dhe sensibilizimin e punonjësve në sektorin privat lidhur me sinjalizimin, duke i ndihmuar ata të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre si sinjalizues potencial.

Gjithashtu, ky doracak synon të promovojë kulturën e transparencës dhe integritetit në institucionet private, duke inkurajuar raportimin e veprimeve të dyshimta në përputhje me ligjin dhe parimet etike.

# Hyrje

Sinjalizimi ka dëshmuar të jetë një ndër mënyrat më efektive të luftimit të korrupsionit dhe të keqpërdorimeve. Duke zbuluar informacione rreth keqpërdorimeve në institucione, sinjalizuesit ndihmojnë në uljen e veprimeve që e dëmtojnë interesin publik, sigurinë, integritetin financiar dhe sundimin e ligjit. Por pavarësisht kësaj, deri vonë, mungesa e hapësirës për raportim e mbi të gjitha mungesa e politikave mbrojtëse ndaj sinjalizuesve si brenda vendit ku punojnë, por edhe jashtë tij, i ekspozon sinjalizuesit ndaj hakmarrjes, duke i bërë ata ta vëjnë në pikëpyetje faktin nëse duhet t'i raportojnë keqpërdorimet apo jo.

Duke i denoncuar veprimet e korrupsionit dhe keqpërdorimeve të tjera, sinjalizuesit ndihmojnë në zbulimin e veprimeve që dëmtojnë interesin publik, sigurinë, integritetin financiar dhe sundimin e ligjit. Ata luajnë një rol kyç në shpërndarjen e informacioneve të rëndësishme dhe ngritjen e vetëdijes së publikut rreth abuzimeve të mundshme.

Ndonëse në esencë, sinjalizimi ka të bëjë me angazhimin publik për të mirën e përgjithshme, ekziston perceptimi negativ në shoqëri ndaj sinjalizuesve, të cilët shpesh marrin epitetin e spiunëve. Prandaj ka qenë shumë e rëndësishme që korniza ligjore që e rregullon sinjalizimin të definojë qartë termat, në mënyrë që të inkurajohet sinjalizimi dhe të pranohet në shoqëri si akt i cili ndikon në uljen e aktiviteteve korruptive.

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përcakton rregullat dhe procedurat e sinjalizimit, të drejtat e sinjalizuesve dhe mbrojtjen e tyre, si dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin. Pra, përveç raportimit të shkeljeve nga institucionet e sektorit publik, ky ligj rëndësi i kushton edhe sektorit privat, dispozitat e të cilit kanë filluar të zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (në janar 2020).

Sipas këtij ligji, sinjalizuesi apo personi që shpalos informata nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore për shkak të sinjalizimit të tij. Sipas nenit 13 të këtij ligji, ekziston sinjalizimi i brendshëm, i jashtëm dhe publik. Në rastin e sinjalizimit të brendshëm, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, sipas këtij neni, informacioni raportohet tek. Punëdhënësi sipas dispozitave të këtij ligji nënkuptohet çdo institucion publik dhe subjekt privat.

Ndërsa, sipas ligjit, procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin publik inicohet me raportimin e informacionit tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si autoritet kompetent, ndërsa për sektorin privat procedura inicohet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Në nenin 17 të këtij ligji është përcaktuar se punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës, i cili është përgjegjës për ta pranuar dhe trajtuar sinjalizimin.

Ndërkaq sa i përket rregullimit të sinjalizimit në kuadër të Bashkimit Evropian duhet theksuar se Parlamenti Evropian në vitin 2019 ka sjellë Direktivën 2019/1937 për mbrojtjen e personave të cilët raportojnë shkelje. Në nenin 8 të kësaj direktive obligohen shtetet anëtare që të sigurojnë se personat juridik privat që kanë pesëdhjetë (50) e më shumë të punësuar të krijojnë kanale dhe procedura për raportim të brendshëm të informacioneve mbi shkeljet që ndodhin në këto institucione.

Sipas kësaj direktive, procedurat për raportim dhe përcjellje të shkeljeve, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat, duhet të garantojnë konfidencialitet të personit raportues, të caktohet një person ose departament kompetent për dërgimin e raporteve, të siguroj informacion të qartë dhe lehtësisht të arritshëm në lidhje me procedurat e raportimit, si dhe të siguroj përgjigje për personin raportues brenda një afati të arsyeshëm, që nuk mund të kaloj 3 muaj pas raportimit.

# Çka është Sinjalizimi?



Sinjalizimi është shpалosja apo raportimi i informacioneve për veprimet dhe mosveprimet që paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik në kontestin e marrëdhënies së punës, pavarësisht se a bëhet fjalë për sektorin publik apo privat.

Duhet të qartësohet se sinjalizimi bëhet vetëm për interes publik dhe jo për interes personal apo privat. Ndërsa për realizimin e interesave apo të drejtave personale, individët duhet të ndjekin procedurat administrative brenda dhe jashtë institucionit apo procedurat gjyqësore.

Pra, ligji e përcakton shprehimisht se veprimet e dëmshme për të cilat mund të sinjalizohet janë çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që cenon interesin e ligjshëm të sinjalizuesit apo personit të lidhur me sinjalizuesin.

## SINJALIZIMI MUND TË PARAQITET:

- me shkrim;
- me postë apo e-mail;
- gojarisht.

Kur informata paraqitet gojarisht, zyrtari përgjegjës e përpilon informatën me shkrim dhe të njëjtën e nënshkruajnë sinjalizuesi dhe zyrtari përgjegjës.

## SINJALIZIMI GËZON MBROJTJE LIGJORE NË RASTET KUR BËHET PËR SHKAK SE:

- shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet;
- personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor;
- ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë;
- shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet; mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet;
- ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit të parave publike ose resurseve të një institucioni publik, kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë;
- një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keqmenaxhim të rëndë;
- informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet që bien në ndonjë nga nënparagrafët e mësipërm ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar.

Çdo veprim ose mosveprim që synon pengimin e raportimit apo shpалosjes në interes publik, është i pavlefshëm dhe zyrtari përgjegjës apo cilido person tjetër në rastet përkatëse ndiqet penalisht sipas dispozitave penale në fuqi në Kosovë.

# Kush është Sinjalizuesi?



Sinjalizues quhet çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cënim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.

Çdo sinjalizues ka të drejtën e mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit, ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar, si dhe mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme. Këto të drejta i janë garantuar sinjalizuesit gjatë kohëzgjatjes së hetimit, pas procedurës së hetimit, si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

Gjithashtu, sipas këtij ligji, sinjalizuesi apo personi që shpalos informata nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore për shkak të sinjalizimit të tij.


## SIPAS LIGJIT, KATEGORI TË PERSONAVE TË CILËT KANË TË DREJTË TË SINJALIZOJNË JANË:

- të punësuarit dhe ish-të punësuarit, pavarësisht nga kohëzgjatja, pagesa dhe natyra e punës;
- bashkëpunëtorët e jashtëm apo të rastit, vullnetar, në praktikë profesionale ose trajnim;
- kandidatët për punësim;
- vullnetarë;
- personat në praktikë profesionale apo trajnim;
- kontraktorët apo nën-kontraktorët e shërbimeve.

Sinjalizuesi ka të drejtë të mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit; ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar; si dhe të mbrojtjes kundër çfarëdo veprimi të dëmshëm që mund të ndërmerret ndaj tij si sinjalizues.

Këto të drejta sinjalizuesit i njihen gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit; pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit; si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me punëdhënësin e tij.





**SINJALIZUESI MBROHET NGA ÇDO VEPRIM I DËMSHËM I MARRË NDAJ TIJ NGA PUNËDHËNËSI PËR SHKAK TË SINJALIZIMIT NË PAJTIM ME DISPOZITAT E KËTIJ LIGJI, DUKE PËRFSHIRË POR PA U KUFIZUAR NË:**

- *shkarkimin nga puna;*
- *pezullimin nga puna;*
- *transferimin brenda ose jashtë subjektit privat pa pëlqimin e tij;*
- *uljen në pozitë;*
- *zvogëlimin e pagesës;*
- *humbjen e statusit dhe privilegjeve;*
- *mos ngritjen në pozitë;*
- *heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;*
- *vlerësime negative në marrëdhënien e punës;*
- *anulimin e një licence ose leje;*
- *përfundimin e një kontrate për mallra apo shërbime;*
- *veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.*

Pra, çdo veprim i dëmshëm ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm. Ndërkaq në rastet kur sinjalizuesi i është nënshtruar ndonjë veprimi të dëmshëm në vendin e punës, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente për shpërblim të dëmit të pësuar nga veprimi i dëmshëm.

Padia kundër veprimit të dëmshëm duhet t'i dërgohet gjykatës kompetente në afat prej 6 muajsh nga dita kur sinjalizuesi është vënë në dijeni, por jo më vonë se 3 vite nga dita kur është ndërmarrë veprimi i dëmshëm. Për punëtorët e sektorit privat, padia duhet t'i dërgohet në Departamentin e Përgjithshëm/ Divizionin Civil të Gjykatës Themelore ku ndodhet selia e punëdhënësit, apo ku sinjalizuesi e ka vendbanimin.

Në rastet kur gjykata kompetente vërteton se sinjalizuesi në kontekst të marrëdhënies së punës ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, vendos, sipas rastit, që ta kthejë në vendin e tij të punës, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të urdhërojë institucionin publik apo subjektin privat të ndërmarrë veprime të caktuara.

Të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin, trajtohen me prioritet nga gjykata, ndërsa barrën e provës që të provojë se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje me sinjalizimin e ka punëdhënësi.



# Kush është zyrtari përgjegjës për sinjalizimin?



Punëdhënësi privat që ka më shumë se 50 të punësuar, është i obliguar të caktoj zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, të cilët janë përgjegjës për ta pranuar dhe trajtuar sinjalizimin.

Në ushtrimin e funksioneve të tyre, zyrtarët përgjegjës duhet të veprojnë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizimit; të ruajnë konfidencialitetin e informatave; të veprojnë të pavarur ndaj qëndrimeve politike apo ndaj çfarëdo ndikimi tjetër të padrejtë që mund të pengojë ushtrimin e detyrave të tyre; të shmangin çdo lloj konflikti potencial të interesit, dhe të zbulojnë atë menjëherë para Autoritetit Kompetent, të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat në lidhje me njoftimin e zhdukjes, fshehjes, ndryshimit, falsifikimit dhe veprimeve të tjera që kanë për qëllim shkatërrimin e tyre etj..

Pra, sinjalizuesi e paraqet informacionin e tij në lidhje me keqpërdorimet në vendin e punës tek personi përgjegjës për sinjalizimin, i caktuar me vendim nga ana e punëdhënësit.

## **PAS PRANIMIT TË INFORMACIONIT, ZYRTARI PËRGJEGJËS EVIDENTON SINJALIZIMIN E PRANUAR DHE KRIJON NJË REGJISTËR, I CILI DUHET TË PËRMBAJË:**

- Datën e pranimit;
- Emrin dhe mbiemrin e sinjalizuesit;
- Të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
- Institucionin e sinjalizuesit;
- Përmbajtjen e shkurtër të informatës.

Nga dita e raportimit të infomacionit fillon hetimi administrativ, i cili duhet të përfundoj në afat prej 45 ditësh. Ky afat, në rrethana të caktuara, mund të shtyhet edhe për 45 ditë të tjera, por e njëjta nuk mund të shtyhet për më shumë se 90 ditë në total nga dita e raportimit të informacionit.

Përgjashtimisht, sinjalizuesi mund t'i drejtohet drejtëpërdrejtë drejtuesit të punëdhënësit, në rastet kur punëdhënësi nuk ka zyrtar përgjegjës, punëdhënësi nuk ka përcaktuar procedura të brendshme për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin, sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit, sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar me sinjalizimin, apo se sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme nuk janë efektive.

## Pse duhet të sinjalizoj?



Sinjalizimi në sektorin privat është po aq i rëndësishëm sa në sektorin publik, pasi që institucionet private gjithashtu ballafaqohen me sfida të korrupsionit dhe keqpërdorimeve të mundshme. Në fakt, sinjalizimi në sektorin privat mund të jetë edhe më i rëndësishëm, pasi që shumë herë veprime të tilla mund të ndikojnë në konkurrencën e ndershme, sigurinë e të punësuarve dhe besimin e klientëve.

Sinjalizuesit në sektorin privat, si punonjës të organizatave, mund të zbulojnë informacione të rëndësishme për produktet e dobëta, mashtrimet, shkeljet e privatësisë dhe veprime të tjera që mund të dëmtojnë klientët. Raportimi i këtyre informacioneve ndihmon në ruajtjen e integritetit të institucionit dhe të besimit të klientëve.

Sinjalizimi në sektorin privat mund të kontribuojë në ndërgjegjësimin e punonjësve dhe menaxherëve rreth rregullave, standardeve etike dhe ligjeve që duhet të ndjekin. Ky proces i ndërgjegjësimit ndikon në kulturën dhe ndërgjegjësimin e përgjithshëm të biznesit për praktikën e ndershme.

Megjithatë, mungesa e hapësirës së sigurtë për raportim dhe mungesa e politikave mbrojtëse brenda dhe jashtë vendit ku ata punojnë mund t'i ekspozojë sinjalizuesit ndaj hakmarrjes. Kjo mund të sjellë dilemën morale për t'a nëse duhet të vazhdojnë të raportojnë krime apo të mbajnë heshtje për të mbrojtur veten.

Prandaj, për të mbrojtur sinjalizuesit dhe për të inkurajuar raportimin e krimeve, është e rëndësishme që institucionet të kenë politika mbrojtëse të fuqishme. Këto politika duhet të ofrojnë mbrojtje për sinjalizuesit, duke siguruar anonimitetin e tyre, si dhe shmangien nga ndjekjet dhe ndëshkimi i padrejtë. Gjithashtu, duhet të krijohen mekanizma të veçantë për grumbullimin e informacioneve dhe hetimin e ankesave të bëra nga sinjalizuesit.

Formalizimin i sinjalizimit si një praktikë e mirëfilltë, e pranuar nga shoqëria, që ekspozon dhe parandalon krimin dhe korrupsionin, tashmë e mbulon Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Si i tillë, është e rëndësishme dhe kuptueshme që ky ligj duhet të respektohet dhe promovohet vazhdimisht, e në veçanti në sektorin privat.

Prandaj është më se e nevojshme që përpjekjet institucionale të suplementohen me një fushatë avokuese e cila duhet të zhvillohet në aspektin promovues dhe informues.

# Kush përfshihet në sektorin privat?



## SEKTORI PRIVAT PËRBEHET NGA TË GJITHA SUBJEKTET JURIDIKE (ETNITETET LIGJORE) QË NUK BËJNË PJESË NË SEKTORIN PUBLIK.

- shoqëritë tregtare;
- organizatat joqeveritare;
- çdo organizatë tjetër të themeluar në bazë të ligjit.

### SHOQËRITË TREGTARE JANË:

- bizneset individuale;
- ortakëritë e përgjithshme;
- ortakëritë e kufizuara;
- shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar;
- shoqëritë aksionare.

### ORGANIZATA JOQEVERITARE JANË PERSONAT JURIDIK TË CILËT MUND TË ORGANIZOHEN NË TRI FORMA, DHE ATË SI:


- shoqatë;
- fondacion;
- institut.

Ndërsa, kategoria e tretë përfshinë personat juridik të cilët kanë fushëveprim specifik dhe rregullohen me ligje të veçanta si: partitë politike, komunitetet fetare, sindikatat, Kryqi i Kuq i Kosovës, etj..



## Cilat janë llojet e sinjalizimit?

Sipas nenit 13 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, egzistojnë tri lloje të sinjalizimit:



Në rastin e sinjalizimit të brendshëm, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, informacioni raportohet tek punëdhënësi (*personi përgjegjës për pranimin e sinjalizimeve*).

Ndërsa, procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin privat inicohet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm pasi ka kryer sinjalizimin e brendshëm apo drejtëpërdrejt sinjalizim të jashtëm, në rastet kur sinjalizimi ka të bëjë me drejtuesin e punëdhënësit, sinjalizimi ka karakter urgjent që ndërlidhet me një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm ose dëme të pakthyeshme; ka dyshime të arsyeshme se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit, provat mund të fshihen ose asgjësohen nëse ky do të kryente sinjalizim të brendshëm, kur sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

Sinjalizim publik konsiderohet shpалosja e informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik.

Sinjalizimi publik bëhet në rastet kur në kohën kur sinjalizuesi bën shpалosjen e informacionit me arsye beson se do t'i nënshtrohet ndërshkimit nëse bën raportim të brendshëm osë të jashtëm, sinjalizuesi me qëllim beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhjen me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen, në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme të riparueshme, apo në rastet kur autoritetet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në lidhje me sinjalizimin brenda afatit prej 6 muajsh nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.

# Për çka mund të sinjalizohet?



Përmes sinjalizimit, i punësuar i sektorit privat raporton apo shpalosë informacione për të cilat beson se janë në interes të publikut dhe kanë tendencë të tregojnë se një ose më shumë nga çështjet vijuese po ndodhin tani, kanë ndodhur në të kaluarën ose ka të ngjarë të ndodhin në të ardhmen.

## ÇËSHTJET E TILLA JANË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- kryerjen e ndonjë vepre penale;
- shkeljen e një detyrimi ligjor;
- shkatërrimin e ambientit;
- rrezikimin e shëndetit apo të sigurisë së individit;
- një mbulim të qëllimshëm të informacionit që synon të tregojë ndonjë nga shkeljet e më sipërme;
- veprimet diskriminuese dhe shtypëse;
- mbrojtja e konsumatorit dhe konkurrencës.

Pra përmes sinjalizimit bëhet zbulimi i informacioneve mbi aktivitetet e paligjshme, mashtruese ose të rrezikshme që kryhen brenda institucionit.

Sinjalizimi mund të bëhet me shkrim, me postë, telefon, e-mail, dhe gojarisht. Nëse sinjalizoni një rast, zyrtari përgjegjës pranon informacion duke krijuar një regjistër i cili përmban të dhënat kryesore për sinjalizuesin dhe datën e pranimit. Sinjalizuesit në momentin e parashtrimit të rastit i jepet dëshmi për informacionin e paraqitur dhe lista me emrat e dokumenteve të cilat janë paraqitura lidhur me rastin.

Pra, sinjalizuesi në momentin e sinjalizimit beson me vetëdije se ekziston kërcënimi apo cenimi i interesit publik. Sinjalizuesi nuk është i detyruar ta provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar, dhe nuk ka detyrim të mbledhë apo sigurojë prova.

Punëdhënësi është i obliguar t'iu sigurojë të punësuarëve udhëzime me shkrim lidhur me procedurat për sinjalizimin.

Udhëzimet si dhe çdo informacion tjetër i dobishëm lidhur me sinjalizimin publikohen dhe përditësohen rregullisht dhe shpërndahen përshtatshëm në mjediset e punëdhënësit dhe në faqe të internetit kur është e mundur teknikisht.

# Skenarë të sinjalizimit në sektorin privat

## Sinjalizimi i brendshëm

Viona është angazhuar si punëtore në një kompani të prodhimit të produkteve të mishit. Gjatë kohës sa ajo kryente detyrat e saj në linjën e prodhimit, zbulon se njëri nga kolegët e saj nuk i përmbahet procedurës së prodhimit të produkteve.

Në vend të produkteve që i posedon kompania dhe për të cilat ka certifikatë adekuate nga ana e autoriteteve kompetente, Viona kuptoj se kolegu i saj po përdorte produkte të tjera që konsiderohen të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Pra, krahas udhëzimeve të përsëritura të shefit të repartit ndaj tij, kolegu vazhdimisht kryente prodhimin e produkteve në kundërshtim me normat e brendshme fitosanitare të punës, edhe pse të njëjtat janë në pajtim me standardet kombëtare të legjislacionit në fuqi.

Ajo vendos të sinjalizojë këtë tek Artoni, i caktuar si person përgjegjës për sinjalizim brenda kompanisë, për të siguruar që çështja të trajtohet me integritet.

**VIONA:** *"Arton, kam zbuluar së njëri nga kolegët tanë nuk i përmbush të gjitha procedurat gjatë prodhimit produkteve të mishit."* (Viona vazhdon të tregoj në lidhje me personin, kohën dhe vendin ku është parë të ketë ndodhur rasti, si dhe provat për të mbështetur raportimin).

**ARTONI:** *"Në rregull, ju faleminderit për raportimin tuaj. Nga ky moment do të filloj hetimi administrativ i cili do të përfundoj sa më herët që është e mundur dhe asesi nuk do të kaloj më shumë se 90 ditë. Tani do të krijoj një regjistër për evidentimin e sinjalizimit, si dhe dëshminë për sinjalizimin e parashtruar."*

Me këtë rast, Viona përfundoj sinjalizimin e brendshëm, pra raportimin e informacionit tek zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Viona është plotësisht e vetëdijshme se ajo mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm i marrë ndaj saj nga punëdhënësi për shkak të sinjalizimit dhe cfarëdo veprimi i dëmshëm i marrë ndaj saj është i pavlefshëm. Në rast se Viona i nënshtrohet ndonjë veprimi të dëmshëm, ajo ka të drejtë t'i dërgohet gjykatës kompetente për të kërkuar dëmshpërblim për dëmet e pësuar nga veprime të dëmshme. Në të gjitha rastet kur Viona konsideron se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, punëdhënësi e ka barrën e provës të provojë se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin.



## Sinjalizimi i jashtëm

Pas përfundimit të sinjalizimit të brendshëm për rastin e shtejlluar më lartë, Viona konsideron se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk do të jenë efektive. Kjo për shkak se, kanë kaluar 90 ditë prej ditës së raportimit të informacionit tek personi përgjegjës për sinjalizimin dhe Viona ende nuk kishte marrë ndonjë informacion për rastin e raportuar.

Rrjedhimisht, Viona vendosi të bëjë sinjalizim të jashtëm dhe fillon të shfletoj Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Aty (*në nenin 19*), Viona vëren se për sinjalizimin e jashtëm në sektorin privat, sinjalizimi duhet të bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësive.

Viona kupton se institucioni kompetent për të bërë sinjalizim të jashtëm në lidhje me prodhimin e mishit në kundërshtim me normat e brendshme fitosanitare të punës është **Agjensioni i Ushqimisë dhe Veterinarisë**.

Agjensioni e pranon sinjalizimin e Vionës dhe fillon të hulumtojë rastin për të verifikuar të dhënat dhe të marrë masat e duhura.

Me këtë rast, Viona ka përfunduar sinjalizimin e jashtëm, pra raportimin e informacionit tek autoriteti kompetent sipas fushës së përgjegjësive.



## Sinjalizimi publik

Për shkak të kërcënimit të madh për shëndetin e njerëzve që mund të ketë mishi i prodhuar në kundërshtim me standardet ndërkombëtare (rasti i shtejlluar tek sinjalizimi i brendshëm), Viona vendosi që për këto shkelje të bëjë edhe sinjalizim publik, përmes njoftimit të mediave.

Natyrisht, Viona ishte e vetëdijshme se me rastin e sinjalizimit publik duhet të respektonte parimin e prezumimit të pafajsisë së personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengoj zhvillimin e procedurave gjyqësore.

Gazetarët filluan të investigojnë thellësisht çështjen dhe të intervistojnë Vionën si sinjalizuese anonime.

Lajmet e reja dëshmojnë se keqpërdorimet kanë pasur ndikim të madh në interesat publike, si dhe shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe se sinjalizimi i Vionës ka pasur ndikim në parandalimin e këtij veprimi.

Në këtë mënyrë, pra, Viona ka përfunduar edhe sinjalizimin publik, pra raportimin e informacionit në media.



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Implementuar nga:

**FOL**

Mbështetur nga:

